VENDIM
Nr. 115, datë 5.3.2014

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DISIPLINORE DHE TË RREGULLAVE PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN E VENDIMMARRJEN NË KOMISIONIN DISIPLINOR NË SHËRBIMIN CIVIL[1]
(Ndryshuar me VKM nr. 437, datë 18.7.2018; nr. 125, datë 27.2.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 59, pika 10, e 69 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë procedurën disiplinore dhe rregullat për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil.

KREU I
ORGANET DISIPLINORE

1. Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt.

2. Komisioni disiplinor, për institucionet e administratës shtetërore, përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka këtë përbërje:

a) nëpunësin më të lartë civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, i cili kryeson komisionin;

b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

c) drejtuesin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku bën pjesë nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

ç) një përfaqësues të DAP-it;

d) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore *ose zëvendëssekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për procedurën disiplinore të nisur, sipas shkronjës "b", të pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi.*

3. Për institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet, komisioni disiplinor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka përbërjen e mëposhtme:

a) nëpunësin më të lartë civil në atë institucion;

b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion;

ç) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

d) nëpunësin më të vjetër civil të njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore *ose zëvendëssekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për procedurën disiplinore të nisur, sipas shkronjës "b", të pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi.*

4. Për komunat, komisioni disiplinor përbëhet nga 3 (tre) anëtarë dhe ka këtë përbërje:

a) nëpunësin më të lartë civil në atë institucion;

b) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion;

c) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.

5. Komisioni disiplinor mblidhet, organizohet dhe funksionon në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale.

6. Në rast të lindjes së nevojës së zëvendësimit të anëtarëve të KD-së, për arsye të pamundësisë apo pengesës

[1] *VKM nr. 115, datë 5.3.2014 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.31, datë 18 mars 2014.*
VKM nr. 437, datë 18.7.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.108, datë 24 korrik 2018.

ligjore, zbatohen dispozitat për zëvendësimin, të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

7. Në rast se ecuria disiplinore zhvillohet për një nga anëtarët e KD-së, ai zëvendësohet nga titullari i institucionit me një tjetër nëpunës civil të institucionit.

KREU II
PROCEDURA DISIPLINORE

1. Me "procedurë disiplinore" do të kuptohet gjithë veprimtaria administrative, që kryhet që nga momenti i konstatimit të një shkeljeje disiplinore, vënies në dijeni, me shkrim, të personit që pretendohet se ka kryer shkeljen, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga organi disiplinor.

2. Nëpunësit e institucionit, kur kanë dijeni apo dyshojnë për shkelje disiplinore, të kryera nga nëpunës të tjerë të të njëjtit institucion, duhet t'ia raportojnë atë, me shkrim, eprorit direkt të nëpunësit për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen.

3. Kur shkeljet janë konstatuar nga shtetas apo institucione jashtë strukturave të institucionit ku bën pjesë nëpunësi për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen, ato i raportohen zyrtarisht institucionit përkatës.

4. Ankesa/rekomandimi në lidhje me shkeljen disiplinore të pretenduar, sipas pikave 2 dhe 3 të kreut II të këtij vendimi, duhet të plotësojë këto kushte:

a) të jetë me shkrim;

b) të identifikojë nëpunësin civil, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore;

c) të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij.

5. Kërkesat anonime nuk pranohen për shqyrtim.

6. Ankesa/rekomandimi i depozituar në institucion, sipas pikës 3 të kreut II të këtij vendimi, i dërgohet eprorit direkt të nëpunësit të cilit i atribuohet shkelja.

6/1 Përjashtimisht, kërkesa/rekomandimi i depozituar në institucion, sipas pikës 3, të këtij kreu, i dërgohet komisionit disiplinor për rastet kur:

a) shkeljet disiplinore të pretenduara janë konstatuar nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje;

b) shkeljet disiplinore të pretenduara janë konstatuar gjatë veprimtarisë së grupit akselerator nga zëvendëssekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

7. Eprori direkt, në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore nëpërmjet ankesave nga publiku, e vlerëson paraprakisht atë.

7/1 Komisioni disiplinor, në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, sipas pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi, e vlerëson paraprakisht atë. Nëse nga vlerësimi i informacionit të marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, komisioni disiplinor vendos të mos e fillojë ecurinë disiplinore.

8. Nëse informacioni i marrë nuk rezulton të ketë elemente që mund të klasifikohen si shkelje disiplinore, eprori direkt vendos të mos e fillojë ecurinë disiplinore.

9. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente të klasifikuara si shkelje disiplinore, eprori direkt bën klasifikimin e shkeljeve sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013.

9/1 Në rast se nga informacioni i marrë, sipas pikës 6/1, të kreut II, të këtij vendimi, rezulton të ketë elemente të klasifikuara si shkelje disiplinore, komisioni disiplinor bën klasifikimin e shkeljeve sipas pikës 1, të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar. Në rast se nga vlerësimi rezulton se:

a) Shkelja klasifikohet në shkeljet e rënda apo shumë të rënda, komisioni disiplinor fillon ecurinë disiplinore;

b) Shkelja klasifikohet në shkeljet e lehta, komisioni disiplinor i kërkon eprorit direkt të fillojë ecurinë disiplinore.

10. Në rast se shkelja klasifikohet në shkeljet e lehta, eprori direkt fillon ecurinë disiplinore. Në rast të kundërt, eprori direkt i kërkon KD-së të fillojë ecurinë disiplinore.

11. Në rast se eprori direkt vihet në dijeni për një shkelje disiplinore nga subjektet e përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013, eprori direkt fillon menjëherë ecurinë disiplinore ose, nëse nuk është kompetent për shqyrtimin e saj, ia përcjell informacionin KD-së.

12. Nëse shkelja që i atribuohet nëpunësit, rezulton se nuk është klasifikuar drejt apo nuk është në juridiksionin lëndor të organit disiplinor që e ka marrë në shqyrtim kërkesën, atëherë ai vendos dërgimin me shkresë zyrtare pranë organit kompetent.

13. Në rastin e marrjes dijeni për një shkelje disiplinore, organi disiplinor fillon ecurinë disiplinore dhe

njofton, me shkrim, nëpunësin përkatës:

a) për shkeljen disiplinore të pretenduar për të;

b) për të drejtën që ai ka për të paraqitur, me shkrim, sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar dhe afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;

c) për të drejtën që ka për të inspektuar dosjen e procedimit, për t'u dëgjuar, ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë, për të paraqitur prova ose për të kërkuar marrjen e tyre;

ç) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet më shpejt se 4 (katër) ditë dhe jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga nëpunësi.

14. Organi disiplinor heton kryesisht të gjitha faktet dhe vlerëson të gjitha rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe mund të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, e, në veçanti, ai kryen veprimet e mëposhtme:

a) pyet ose merr deklarata nga dëshmitarët dhe verifikon faktet kundërshtuese;

b) rishikon dokumentacionin përkatës për mospërputhje, për fakte që mungojnë, data apo firma që janë hequr etj.;

c) shqyrton dosjen e nëpunësit;

ç) thërret nëpunësin për t'u njohur me variantin e tij të ngjarjeve apo të problemit;

d) verifikon praktikat dhe rastet e procedimeve disiplinore të mëparshme;

e) kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes.

15. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas pikës 14 të kreut II të këtij vendimi, organi disiplinor i vë në dispozicion nëpunësit që po procedohet materialet e mbledhura gjatë këtij hetimi.

16. Në seancën dëgjimore nëpunësi paraqitet vetë ose cakton një përfaqësues, sipas ligjit. Në rast se pas dy njoftimeve të njëpasnjëshme, nëpunësi apo përfaqësuesi i tij nuk paraqiten, ecuria disiplinore vazhdon në mungesë.

17. Organi disiplinor, pasi shqyrton çështjen sipas pikave 13, 14 dhe 15 të këtij vendimi, dhe pasi ka dëgjuar nëpunësin përkatës ose përfaqësuesin e tij ligjor, apo vë në dukje, me shkrim, mosparaqitjen e tij, megjithëse nëpunësi ka marrë dijeni rregullisht, vendos marrjen e masës disiplinore ose ndërprerjen e ecurisë disiplinore.

18. Vendimi për ndërprerjen e ecurisë disiplinore merret nga organi disiplinor në rastet kur:

a) nuk ka shkelje disiplinore, siç ishte menduar;

b) rezulton se nëpunësi nuk ka kryer shkelje me faj;

c) veprimi nuk ka qenë ose nuk është kryer nga nëpunësi përkatës.

19. Vendimi përfundimtar i organit disiplinor përmban këto të dhëna:

a) organin që ka marrë vendimin;

b) identifikimin e nëpunësit ndaj të cilit është marrë masa;

c) masën e marrë;

ç) shkeljen faktike;

d) bazën ligjore;

dh) arsyetimin e vendimit dhe shpjegimin e fakteve që janë bërë shkas për marrjen e vendimit;

e) rastet e mëparshme të shkeljeve të ngjashme dhe të masave disiplinore të marra;

ë) një listë dhe kopje të të gjitha dokumenteve që mbështesin masën disiplinore të dhënë, nëse këto kërkohen nga nëpunësi nën procedim;

f) të drejtën që ka nëpunësi i ndëshkuar për t'u ankuar dhe afatet e ankimimit.

20. Një kopje e vendimit, së bashku me materialet shoqëruese, u jepen nga organi disiplinor nëpunësit dhe njësisë përgjegjëse, brenda 4 (katër) ditëve nga dhënia e tij. Kopja e vendimit bëhet pjesë e dosjes personale të tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama